



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HAS**

**Shtojca 10**

*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

[ 09 / 11 / 2023 ]

Drejtuar: **Operatori ekonomik “ERZENI/SH” sh.p.k.**  
Adresa: Lagjja Bahçallek, Rruga Nacionale Shkoder-Tirane, nr pasurie 17/910, zona kadastrale 8591, Shkoder.

Procedura e prokurimit/lotit: **“E Hapur e Thjeshtuar - Mallra”**,

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-83516-10-12-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje pajisje mobilerie, Shkolla e mesme “Skenderbeu” Krumë”**.  
Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 30 (Tridhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Buletini Nr. 86 datë 16 Tetor 2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. “KLAME” sh.p.k.**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**K21518003F**

*Numri i NIPT-t*

Vlera **2,994,280 Lekë pa t.v.sh.** ( *Dy milion e nentëqind e nentëdhjetë e kater mije e dyqind e tetëdhjetë*).

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

- 2. “IGLI-SAND” sh.p.k.** **J94625209A**  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera **3,125,000 Lekë pa t.v.sh.** (Tre milion e njeqind e njetete e pese mije)  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)
- 3. “MUCA” sh.p.k.** **K01421002H**  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera **3,133,800 Lekë pa t.v.sh.** (Tre milion e njeqind e tridhjetete e tre mije e teteqind)  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)
- 4. “ERZENI/SH” sh.p.k.** **J66902027T**  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera **3,532,900 Lekë pa t.v.sh.** (Tre milion e peseqind e tridhjetete e dy mije e nenteqind)  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)
- 5. “EDUART XHIXHA PF** **L54424205B**  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera **3,745,000 Lekë pa t.v.sh.** (Tre milion e shtateqind e dyzete e pese mije)  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)
- 6. “ERALD” sh.p.k.** **J74517205P**  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera **3,839,500 Lekë pa t.v.sh.** (Tre milion e teteqind e tridhjetete e nente mije e peseqind)  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)
- 7. “BOLT” sh.p.k.** **K91517011V**  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera **3,981,000 Lekë pa t.v.sh.** (Tre milion e nenteqind e tetedhjetete e nje mije)  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)
- 8. “SHAGA” sh.p.k.** **J96822229J**  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera **4,035,530 Lekë pa t.v.sh.** (Kater milion e tridhjetete e pese mije e peseqind e tridhjetete)  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)
- 9. “M.LEZHA” sh.p.k.** **J76504013C**  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera **4,183,150 Lekë pa t.v.sh.** (Kater milion e njeqind e tetedhjetete e tre mije e njeqind e pesedhjetete)

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

**10. “DOKSANI - G” sh.p.k.**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L21809501H**

*Numri i NIPT-it*

Vlera **4,900,000 Lekë pa t.v.sh.** (*Kater milion e nenteqind* )

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. “KLAME” sh.p.k.**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**K21518003F**

*Numri i NIPT-it*

**Për arsyet e mëposhtme:**

**Se pari**, operatori ekonomik “Klame” sh.p.k. nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, pika 1 c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 dhe Listën e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Operatori ekonomik “Klame” sh.p.k. ka paraqitur oferten ekonomike te shprehur vetem me numra dhe jo me fjale, kjo ne kundërshtim me Dokumentat Standarte te Tenderit, Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë. Pika B. Pergatitja e Ofertave 4. Formularët e tenderit dhe Listat Çmimeve: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar. Pika F. Vleresimi i ofertave, Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.

**Se dyti**, operatori ekonomik “Klame” sh.p.k. nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, pasi ka paraqitur per kete procedure prokurimi Shtojca 1/1 [ *Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant per ngrrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet*].

**Se treti**, operatori ekonomik “Klame” sh.p.k. nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, 2.3 Kapaciteti Teknik: 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **8 (Tetë) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë: 1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme. 2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Disponimi i numrit te punonjesve do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart. Operatori ekonomik, ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, Shtojca 8, nuk ka percaktuar numrin e punonjesve qe disponon per secilin muaj te periudhes Korrik - Gusht – Shtator 2023, qe perkojne me periudhen e kerkuar ne DST ( 3 muajt e fundit).*

**2. “IGLI-SAND” sh.p.k.**

**J94625209A**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

**Për arsyet e mëposhtme:**

Operatori ekonomik “Igli-Sand” sh.p.k. nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, pika 1 b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes.

**3. “MUCA” sh.p.k.**

**K01421002H**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

**Për arsyet e mëposhtme:**

**Se pari**, operatori ekonomik “Muca” sh.p.k. nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, pika 1 c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 dhe Listën e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2; Formulari i Ofertes sipas Shtojca 1 eshte plotesuar per autoritetin kontraktor Bashkia Kukes.

**Se dyti**, operatori ekonomik “Muca” sh.p.k. nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, 2.3 Kapaciteti Teknik 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **8 (Tetë) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë: 1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme. 2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme. *Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Disponimi i numrit te punonjesve do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart. Operatori ekonomik ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit sipas Shtojces 8 Pjesa II, pika B “Deklarate per disponimin e punonjesve dhe makinerive te nevojshme (nese kerkojen)” nuk ka percaktuar numrin e punonjesve qe disponon per muajt Korrik - Gusht – Shtator 2023.*

**Se treti**, operatori ekonomik “Muca” sh.p.k. nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, 2.3 Kapaciteti Teknik 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi **1 (Nje) automjet** të përshtatshëm për transport mallrash të cilët duhet t'i ketë në pronësi ose me qira, dhe për të cilët duhet të paraqesë

dokumentacionin përkatës, që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Çertifikate për transport mallrash. Në rast se automjeti disponohet me qira, duhet të paraqitet dhe kontrata përkatëse e qerasë, në emër të subjektit, të lidhura para noterit dhe afati i të cilave të përfshijë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi. Disponimi i automjetit do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart. Operatori ekonomik ne Formularin Përmbledhes te Vetedeklarimit sipas Shtojces 8 Pjesa II, pika B “Deklarate per disponimin e punonjesve dhe makinerive te nevojshme (nese kerkohen)” nuk ka dhene llojin e mjetit qe disponon, ku perfshihet, targa, shasia etj.

#### **4. “ERALD” sh.p.k.**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**J74517205P**

*Numri i NIPT-it*

#### **Për arsyet e mëposhtme:**

**Se pari**, operatori ekonomik “Erald” sh.p.k. nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, pika 1 b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes.

**Se dyti**, operatori ekonomik “Erald” sh.p.k. nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, pika 2.3 Kapaciteti Teknik 2.3.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit që prokurohet. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës per U.N.D.P. Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur fatura tatimore të shitjes per kontraten me autoritet kontraktor Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise.*

#### **5. “BOLT” sh.p.k.**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**K91517011V**

*Numri i NIPT-it*

#### **Për arsyet e mëposhtme:**

**Se pari**, operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k. nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, pika 1, a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik, ka paraqitur Formularin Përmbledhes te Vetedeklarimit, Shtojca 8, i cili nuk eshte plotesuar sakte, pasi ne Pjesa II, pika B “Deklarate per disponimin e punonjesve dhe makinerive te nevojshme (nese kerkohen)” nuk eshte percaktuar numri i punonjesve qe disponon per periudhen Korrik - Gusht – Shtator 2023, qe perkojne me periudhen e kerkuar ne DST ( 3 muajt e fundit).

**Se dyti**, operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k. nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, pika b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Sigurimi i ofertes i paraqitur nga operatori ekonomik me numer serie

230606726, e leshuar nga kompania e sigurimeve Albsig sh.a. është me vlerën 89,151.52 Leke. Shuma e siguruar për këtë procedurë prokurimi nuk e mbulon vlerën e kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, e cila është përcaktuar 98,151.52 Leke ( 2% e fondit limit: 4,907,576 \* 2% = 98181.52 Leke).

**Se treti**, operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, 2.3 Kapaciteti Teknik: 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **8 (Tetë) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë: 1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme. 2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Disponimi i numrit të punonjësve do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart. Operatori ekonomik, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Shtojca 8, nuk ka përcaktuar numrin e punonjësve që disponon për secilin muaj Korrik - Gusht – Shtator 2023, që perkojnë me periudhën e kërkuar në DST ( 3 muajt e fundit).

**Se katerti**, operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, 2.3 Kapaciteti Teknik: 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit dhe vendosjes së mallrave/ pajisjeve objekt prokurimi në adresat që do të përcaktohen në planin e shpërndarjes. Deklarata e paraqitur nga operatori ekonomik Bolt sh.p.k. është bere në favor të autoritetit kontraktor Identitek sha dhe jo në emër të Bashkia Has.

**Se pesti**, operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, 2.3 Kapaciteti Teknik: 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një **deklaratë garancie**, për periudhën e garancisë së mallrave/ pajisjeve objekt prokurimi (jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e dorëzimit të pajisjeve), gjatë së cilës do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Deklarata e paraqitur nga operatori ekonomik Bolt sh.p.k. është bere në favor të autoritetit kontraktor Identitek sha dhe jo në emër të Bashkia Has.

## 6. **“SHAGA” sh.p.k.**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**J96822229J**

*Numri i NIPT-it*

### **Për arsyet e mëposhtme:**

**Se pari**, operatori ekonomik “Shaga” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, pika 1, a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik nuk ka plotësuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojca 8 sipas formatit të paraqitur në Dokumentat Standarte të Tenderit.

**Se dyti**, operatori ekonomik “Shaga” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, pika 2.3 Kapaciteti Teknik 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **8 (Tetë) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë: 1. Vërtetim të

lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme. 2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme. *Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.* Disponimi i numrit të punonjesve do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart. Formulari Përmbledhes i Vetedeklarimit sipas Shtojces 8 nuk është plotësuar sakte, pasi në Pjesën II, pika B “Deklarate për disponimin e punonjesve dhe makinerive të nevojshme (nese kerkohen)” nuk ka përcaktuar numrin e punonjesve që disponon për muajt Korrik - Gusht – Shtator 2023, sidhe nuk ka paraqitur listepagesat e muajit Shtator 2023 dhe as vertetimin për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore përfshirë muajin Shtator 2023. Afati i fundit i deklarimit të listepagesave për muajin Shtator 2023 është data 20 Tetor 2023. Procedura e prokurimit është zhvilluar me datë 24 Tetor 2023.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“ERZENI/SH” sh.p.k.**, me adresë *“Lagjja Bahçallek, Rruga Nacionale Shkoder-Tirane, nr pasurie 17/910, zona kadastrale 8591, Shkoder”*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **3,532,900** (Tre milion e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e nentëqind) Lekë pa t.v.sh. / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**